



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA ELBASAN**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE ORGANIZATIVE**

**Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore**

**Lënda: Kërkesë për publikim vendi të lirë pune**

Për shkak të plotësimit të funksioneve të saj në fushën e projektimit të investimeve publike të nisur nga mungesa e inxhinierit elektrik Bashkia Elbasan, ka vendosur të shpallë vend vakant me kohë të pjeshme në pozicionin “Inxhinier Elektrik”, “Drejtimi Energjistik”, i cili do të merret me projektimet elektrike, telefoni dhe IT për një periudhë deri në fund të vitit 2022.

Për këtë arsye , në përputhje me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nenligjore dalë në bazë e në zbatim të tij, bëjmë publikimin e pozicionit të lirë në faqen zyrtare të Bashisë Elbasan si dhe në stendat e Informacionit.

Bashkëlidhur do të gjeni kushtet dhe kriteret përkatëse për pozicionin e mësipërm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

## **DOKUMENTACIONI , MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

***Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:***

a-Jetëshkrim i personit (CV)

b-Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;*

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

***Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:***

a – Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal Master Shkencor “Shkenca Inxhinierike”. Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në një nga degët e Arsimit të Lartë.

b- Të ketë të paktën mbi 5 vite përvojë pune.

c-Të jetë i pajisur me liçencë në projektim për punime elektrike.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda date **09.05.2022**, pranë Bashkisë Elbasan , dorazi apo me postë.